



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 shkurt 2022  
Nr.ref.:RK 1941/22

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI24/21**

Parashtrues

**Rasim Pnishi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr.  
2767/2020 të 21 dhjetorit 2020**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rasim Pnishi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i dytë i kërkesës) nga fshati Damjan, komuna e Gjakovës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2767/2020, të 21.12.2020, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë PPP. nr. 26/2020, të 07.05.2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë P. nr. C. nr. 223/17 të 22 majit 2019.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 29 janar 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 shkurt 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe me të njëjtin njoftim Gjykata kërkoi nga parashtruesi që të dorëzojë në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e rastit dhe ia përcolli të njëjtës një kopje të kërkesës.
7. Më 5 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 2 mars 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti që të dorëzojë në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
9. Më 14 prill 2021, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të paragrafit 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21 u konfirmua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani do të merrte pozitën e Kryetares së Gjykatës pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit nr. KI24/21, caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.
13. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 22 tetor 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Gjakovë që të dorëzojë në Gjykatë një kopje të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C. nr. 223/17, të 22 majit 2019, si dhe informatat lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me aktgjykimin e kërkuar të Gjykatës Themelore në Gjakovë, parashtrori kërkesë për përsëritje të procedurës. Përmes këtij njoftimi Gjykata po ashtu ka kërkuar informata për procedurën lidhur me këtë kërkesë. Përkitazi me këtë shkresë, Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Gjykata Themelore në Gjakovë.
15. Më 24 nëntor 2021, Gjykata njoftoi Këshillin Gjyqësor të Kosovës lidhur me mos përgjigjen e Gjykatës Themelore në Gjakovë ndaj shkresës së Gjykatës. Me këtë shkresë, Gjykata kërkoi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të shfrytëzojë kompetencat e tij për të motivuar Gjykatën Themelore në Gjakovë që t'u përgjigjet shkresave të dërguara më parë nga Gjykata.
16. Më 25 nëntor 2021, Gjykata Themelore në Gjakovë i dorëzoi Gjykatës një kopje të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C. nr. 223/17, të 22 majit 2019, si dhe informatën se lidhur me kërkesën për përsëritje të procedurës sipas këtij aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Gjakovë, procedura është në pritje në Gjykatën e Apelit.
17. Më 20 janar 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

18. Gjykata, në bazë të shkresave të lëndës dhe kërkesës së parashtruesit, vëren se në këtë rast lidhur me të njëjtën çështje juridike, janë iniciuar dy procedura të veçanta gjyqësore si dhe procedura përmbartimore, dhe se ato kanë specifikat e tyre. Procedura e parë gjyqësore i referohej procedurës kontestimore me të cilën është kërkuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë që të vërtetojë ekzistimin e borxhit dhe ta obligojë parashtruesin që ta paguajë atë. Lidhur me këtë çështje është nxjerrë aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 223/17, të 22 majit 2019, procedura e dytë gjyqësore kishte të bënte me kërkesën e parashtruesit për kthim në gjendje të mëparshme të rastit, në të cilën u nxor Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 223/17 i 22 majit 2019, ndërsa në të njëjtën kohë janë duke u zhvilluar procedura përmbartimore me qëllim të ekzekutimit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 223/17 të 22 majit 2019.

### ***Procedura e zhvilluar kundër parashtruesit të kërkesës me qëllim të përcaktimit të borxhit dhe obligimit të parashtruesit për pagesën e tij***

19. Në një datë të pacaktuar, L. Z filloi procedurën kundër parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore në Gjakovë për vërtetimin e borxhit dhe shlyerjen e tij, që rrjedhin nga kontrata për shitblerje të veturës.
20. Më 22 maj 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme Gjykata Themelore) me Aktgjykimin [C. nr. 223/17] pranoi kërkesën e L. Z, duke vërtetuar ekzistimin e borxhit dhe obligoi parashtruesin e kërkesës për ta paguar borxhin e vërtetuar. Ky vendim mori formë të prerë më 03.12. 2019.

### ***Procedura e iniciuar me qëllim të përmbartimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C. nr. 223/17 të 22 majit 2019***

21. Më 13 janar 2020, kreditori L. Z ka parashtruar kërkesë për përmbartim të përmbartuesi privat GJ.R, me seli në Gjakovë, kundër parashtruesit të kërkesës, me qëllim të pagesës së borxhit të përcaktuar sipas dokumentit përmbartues - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë [C. nr. 237/17] të 22 majit 2019. Të njëjtën ditë, përmbartuesi privat GJ.R në pajtim me urdhrin për përmbartim P. nr. 03/20, lejoi përmbartimin me propozim të kreditorit.
22. Më 24 janar 2020, kundër urdhrin për përmbartim [P. nr. 03/20] të 13 janarit 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kundërshtim në Gjykatën Themelore, “për shkak të shkëlqes së dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat në mënyrë supsiadiare aplikohen edhe në këtë procedurë përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të gjendjes materiale”.
23. Më 7 maj 2020, Gjykata Themelore me Aktvendimin [PPP. nr. 26/20] refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar, “Gjykata, aktvendimin përkitazi me refuzimin në rastin konkret e ka mbështetur edhe në nenin 71 të LPP-së, pasi që gjeti se pretendimet e paraqitura në prapësim nga ana e debitorit, nuk hyjnë në shkaqet e parapara me këtë nen, të cilat po qe se ekzistojnë mund të pengojnë

*përmbarrimin e lejuar dhe në nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, ku theksohet se “baza e prapësimit duhet të mbështetet me provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”, pasi që debitori nuk ja ka bashkangjitur as edhe një provë t[ vetme me shkrim prapësimit, e cila do të mund të ndryshonte mënyrën e vendosjes së këtij aktvendimi, andaj në kuptim të nenit 73.3 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi”.*

24. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës kundër aktvendimit [PPP. nr. 26/20] të Gjykatës Themelore, të 7 majit 2020, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit “*për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale*”.
25. Më 21 dhjetor 2020, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin [Ac. nr. 2767/2020] refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore, me arsyetimin se, “*përmbarrimi është caktuar në bazë të titullit përmbarrimor Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C. nr. 223/17 të datës 22.05.2019, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 03.12.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 23.12.2019. Ky aktgjykim paraqet dokument përmbarrimor në kuptim të nenit 22 të LPP-së dhe është i përshtatshëm për përmbarrim në kuptim të nenit 27 të LPP-së. Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se, aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje përmbarrimore. Për këto arsye edhe ka vendosur që pretendimet ankimore të kreditorit të refuzohen në tërësi si të pabazuara dhe që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet*”.

***Procedura lidhur me kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme të lëndës në të cilën është nxjerrë aktgjykimimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 223/17 i 22 majit 2019***

26. Më 23 janar 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore në Gjakovë kërkesën për përsëritje të procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 223/17, të 22 majit 2019, me pretendimin se nuk e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar dhe se nuk ka dijeni për përmbajtjen e tij, me propozimin për anulimin e klauzolës së plotfuqishmërisë dhe përmbarrueshmërisë së procedurës së nisur përmbarrimore.
27. Më 30 janar 2020, Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të parashtruesit të kërkesës, ia përcolli Gjykatës së Apelit propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës, të përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 223/17, të 22 majit 2019. Kjo procedurë është ende në pritje.

## Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotjtja e pronës) të KEDNJ-së.
29. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arsyetuar se si kanë ndodhur shkeljet e përmendura të neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, por në parashtrësën e tij, theksoi

*“Unë fare nuk e kam marrë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 223/17 të datës 22 maj 2019 i cili është bërë i plotfuqishëm edhe pse unë personalisht nuk e kam marrë. Unë lidhur me këtë Aktgjykim jam njoftuar nga përmbaryesi privat kur më ka dërguar propozimin për përmbaryim atëherë e kam marrë vesh që ekziston Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 223/17 të datës 22 maj 2019 i cili në mënyrë të kundërligjshme është bërë i plotfuqishëm pa e pranuar unë fare. Unë po ta kisha marrë patjetër se do të kisha bërë ankesë dhe nuk do të e lejoja kurrësesi që i njëjti të bëhet i plotfuqishëm por do të ushtroja ankesë, mirpo meqë nuk e kam marrë fare nuk kam bërë dhe nuk kam mund që të bëjë ankesë. Pra ai është bërë i plotfuqishëm edhe pse unë nuk e kam marrë. Nuk ka nënshkrim timin mbi pranimin e atij aktgjykimi”.*

30. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon zbatimin e gabuar të ligjit, konkretisht,

*“bëhet fjalë për shumë pa rregullësi, duke u bazuar në kuptim të nenit 73 të LPK. Andaj edhe nuk janë krijuar kushtet ligjore që propozimi për përmbaryim të kryhet. Arsyetimi i parashtruar në kërkesë për kthimin e gjendjes së mëparshme dhe ankesë shërbejnë edhe për këtë prapsim. Për ndryshe çka është më e rëndësishme, nuk janë krijuar kushtet ligjore që propozimi për përmbaryim të kryhet deri sa të vendoset lidhur me kërkesën për kthimin e gjendjes së mëparshme dhe ankesës sime kopjet e të cilave gjenden në shkresat e lëndës. Pra siç kam cekur edhe në kërkesën time për kthimin e gjendjes së më parshme unë fare nuk e kam marrë Aktgjykimin C. nr. 237117 të datës 22.05.2019 sepse po ta kisha marrë patjetër do të ushtroja ankesë. Nuk ka askund nënshkrim timin që kam marrë aktgjykimin e lartëcekur ashtu që ai nuk ka pasë asnjë mundësi të bëhet i plotfuqishëm, ashtu që është bërë i plotfuqishëm pa më njoftuar mua fare në mënyrë të kundërligjshme. Shpresoj se Gjykata do të kthenë gjendjen e më parshme dhe heqjen e klauzulës së plotfuqishmërisë”.*

31. Në fund, parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata që t'i anulojë dhe t'i shpallë jokushtetuese aktvendimet gjyqësore të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PPP. nr. 26/2020, të 07.05.2020 dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2767/2020 të 21.12.2020.

## Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë, të parashikuara në Ligj dhe të specifikuara më tej në Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

34. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

### Neni 47 (Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

### Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

35. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, që specifikon:

### Rregulli 39 Kriteret e pranueshmërisë

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.*

*(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese”.*

36. Në anën tjetër, sa i përket përbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj, të cilat janë shtjelluar më lart, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës [AC. nr. 2767/2020], të 21 dhjetorit 2020.
37. Në vijim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (1) (b) dhe (d) të Rregullores së punës dhe neneve 47 dhe 48 të Ligjit, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës ka theksuar se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

***i) Lidhur me procedurën përmbarimore e cila është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP. nr. 26/20] të 7 majit 2020 dhe miratuar me aktvendimin [AC. nr. 2767/2020] të Gjykatës së Apelit të 21 dhjetorit 2020***

38. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës nuk konteston në Gjykatë procedurën përmbarimore, e cila u vërtetua me aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP. nr. 26/20] të 7 majit 2020 dhe u miratua me aktvendimin [AC. nr. 2767/2020] e 21 dhjetorit 2020 të Gjykatës së Apelit dhe në këtë mënyrë parashtruesi i kërkesës nuk deklaroi se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur me këto akte të autoritetit publik.
39. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se në mënyrë që kërkesa të konsiderohet se i plotëson kriteret e pranueshmërisë, parashtruesi i kërkesës është i detyruar të deklarojë në kërkesë saktësisht se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe të paraqet në mënyrë adekuate faktet dhe pretendimet për shkeljen e të drejtave ose dispozitave kushtetuese.
40. Në rrethanat e këtij rasti, lidhur me procedurën përmbarimore, përkatësisht aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP. nr. 26/20] të 7 majit 2020 dhe aktvendimin [AC. nr. 2767/2020] të 21 dhjetorit 2020 të Gjykatës së Apelit, kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe në pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

***ii) Sa i përket procedurës së zhvilluar lidhur me kërkesën për kthimin e lëndës në gjendjen e mëparshme në të cilën është nxjerrë aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C. nr. 223/17, i 22 majit 2019***

41. Në lidhje me këtë, sipas informatave të marra, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore me propozimin për iniciimin e kërkesës për



përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, C. nr. 223/17 të 22 majit 2019.

42. Më 30 janar 2020, Gjykata Themelore, duke vepruar sipas propozimit të parashtruesit të kërkesës, ia dërgoi Gjykatës së Apelit propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, C. nr. 223/17, të 22 majit 2019.
43. Në lidhje me këtë, rezulton se, në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës, paralelisht me kërkesën e parashtruesit të dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese, është duke u zhvilluar një procedurë gjyqësore në Gjykatën e Apelit, në të cilën ende nuk është marrë vendimi në lidhje me propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, C. nr. 223/17, të 22 majit 2019.
44. Në këtë aspekt, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ nuk kërkon që mjetet juridike diskrecionale, apo mjetet juridike që nuk janë drejtpërdrejtë në dispozicion të parashtruesve dhe që varen nga ushtrimi i diskrecionit nga ndërmjetësi, të shterohen para se parashtruesit t'i drejtohen GJEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *X dhe të tjerët kundër Letonisë*, Vendim i 6 qershorit 2008, paragrafi 20, dhe referencat e cekura aty).
45. Megjithatë, Gjykata po ashtu rikujton se tashmë ka përcaktuar në praktikën e saj gjyqësore se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër te gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe rastin kur procedura në Gjykatën e Apelit është duke u zhvilluar sipas kërkesës për përsëritje të procedurës të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, atëherë kërkesa e parashtruesve konsiderohet e parakohshme (shih rastin e Gjykatës KI102/16, me parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 14 dhjetorit 2016, paragrafët 37-39).
46. Në këtë drejtim, Gjykata thekson faktin se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje ligjore nga Gjykata Themelore të cilat kanë të bëjnë me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë C. nr. 223/17 të 22 majit 2019, mund të shqyrtohen nga Gjykata e Apelit.
47. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se përkitazi me procedurën e cila zhvillohet në lidhje me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme të lëndës, parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese para se të shterojë të gjitha mjetet efektive juridike, përkatësisht pa pranuar aktvendimin e Gjykatës së Apelit lidhur me kërkesën për përsëritje të procedurës.
48. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet efektive juridike

në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.

49. Në këtë mënyrë, duke u mbështetur në parimin e subsidiaritetit, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre gjatë procedurës së rregullt gjyqësore para se çështja të vjen në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkëljen e pretenduar (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI43/20, parashtrues, *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2020, paragrafi 13, si dhe rastin e Gjykatës KI19/20, parashtrues, *Lutfi Shantir*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrikut 2020, paragrafi 36, shih gjithashtu, rastin e GJEDNJ-së *Aksoy kundër Turqisë*, Aktgjykimi i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).
50. Andaj, lidhur me këtë, Gjykata bazuar në praktikën e saj gjyqësore thekson se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër pranë gjykatave të rregullta, atëherë kërkesat e parashtruesve në Gjykatën Kushtetuese konsiderohen të parakohshme (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, KI09/19, parashtrues *Leutrim Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2019, paragrafi 41; KI23/10, parashtruese *Jovica Gadžić*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 shtatorit 2013, paragrafi 47; dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 marsit 2017, paragrafi 39).
51. Gjykata potencon se ky Aktvendim për papranueshmëri nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që në të ardhmen, sërish, të dorëzojë kërkesë kushtetuese brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor nga dita që ka pranuar vendimin e fundit nga gjykatat e rregullta. Me këtë vendim të Gjykatës konstatohet që, tani për tani, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme për arsye se legjislacioni në fuqi parasheh mjete efektive juridike përmes të cilave parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore dhe kushtetuese.
52. Rrjedhimisht, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

## **Përfundim**

53. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkëljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë (i) në lidhje me procedurën përmbarrimore duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi si qartazi të pabazuara sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës nuk i plotësojnë kërkesat e pranueshmërisë, siç përcaktohet në nenin 48 të Ligjit dhe pikës (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe (ii) pretendimet në lidhje me procedurën e zhvilluar lidhur me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme të lëndës janë të parakohshme dhe duhet të deklarohen të papranueshme, në baza kushtetuese, siç përcaktohet në nenin 113.7 të

Kushtetutës, parashikohet në nenin 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej në rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (1) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 20 janar 2022, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljajfi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Enesa Caka-Nimani

